



Shqipëria me një sipërfaqe prej 28,748 km<sup>2</sup> ka pësuar ndryshime territoriale rrejtësore në 100 vitet e fundit. Ndryshimet filluan të lënë gjurmë në dokumente pas shpalljes së pavarësisë duke shënuar edhe fillimet e proceseve planifikuese të territorit. Përpjekjet e para për njohje dhe planifikim të territorit i kanë bërë ushtarët austriakë me krijimin e hartave topografike. Më pas urbanistë italianë prodhuan studime e plane rregulluese, duke ndryshuar pamjen e disa vendbanimeve kryesore dhe shërbyen si udhërrëfyes për planifikimin urbanistik të qyteteve të pasluftës. Shqipëria u transformua tërësisht gjatë periudhës së regjimit totalitar, si pasojë e planifikimit të centralizuar. Nga një vend me vendbanime me karakter kryesisht rural, u shndërrua në një vend ku jeta zhvillohej dendur në qytete dhe ku fshatrat u emancipuan si qendra të organizimit të jetës me të gjithë komponentët e saj. Ndryshimi i regjimit pas vitit 1991 u përçua menjëherë dhe drejtpërdrejtë në territor. Shqipëria u transformua tërësisht për herë të dytë, por këtë radhë me iniciativë të lirë dhe në mënyrë krejtësisht spontane. Urbanizimi i tokës bujqësore dhe asaj bregdetare janë shenjat më të dukshme të transformimit. Zhvendosja e popullsisë drejt qendrave të mëdha urbane dhe zonave bregdetare janë fenomene që sollën ndryshim rrejtësor të jetës sociale dhe ekonomike në vend, sikurse edhe të mjedisit. Me sy të lirë perceptojmë ndryshimet e theksuara që shoqëruan periudhën e tranzicionit. Konsumimi i tokës bujqësore, i pyjeve, natyrës së lirë, pejsazheve të bregdetit apo gjetkë, janë fenomene me të cilat është përballur territori në 27 vitet e fundit. Trendi botëror i urbanizimit, ku pritet që në vitin 2030 mbi 70% e popullsisë të vendoset në qytete, natyrshëm ka prekur edhe Shqipërinë. Përpjekja e politikëbërësve është që të përgatitemi për të udhëhequr urbanizimin e shoqërisë, duke mësuar nga gabimet e së shkuarës.


Në vijim të një periudhe 4 vjeçare të planifikimit të territorit dhe njohjes së deritanishme, ju ofrojmë këtu një panoramë numerike dhe disa pyetje për të ushtruar mendimin.

SA E NJOHIM TERRITORIN?  
SI DUKET E ARDHMJAJ?



### Drejt 2030 - Projektet prioritare që zbatojnë PPV-të

PPV-të e 44 bashkive kanë evidencuar nevojën për rreth 4430 projekte prioritare dhe pilot në planet e tyre të veprimit, prej të cilave afërsisht 13 % kanë karakter rajonal. Grafiku i mëposhtëm shfaq fushat e projekteve, ku del në pah nevoja për investime në infrastrukturë transporti, shërbime publike dhe mbrojtjen e mjedisit.



**Planifikimi kombëtar i territorit**  
Ndryshimi i drejtimet në qeverisje në vitin 2013 dhe reforma e planifikimit të territorit të vitit 2014 sollën hartimin e dokumentit të parë kombëtar për planifikimin e territorit pas viteve 90-të, i cili është pagëzuar si Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT), Shqipëria 2030, miratuar me VKM nr.881, datë 14.12.2016.

Paralelisht me të, u hartuan për herë të parë në zbatim të ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, edhe dy plane të integruara ndërsektoriale (PINs) për dy rajonet më të rëndësishme të jetës ekonomike dhe sociale në vend: Brezi Bregdetar dhe Zona Tiranë-Durrës. Pas reformës administrative territoriale në vitin 2014 Shqipëria kaloi një tjetër proces reformimi të administrimit të territorit, ku numri i njëjësive të qeverisjes vendore u bë 61. Si rrjedhojë kemi bashki më të mëdha, të cilat duhet të administrojnë territore tepër komplekse.

**Planifikimi në ekonominë e tregut**  
Planifikimi i territorit (me termin që përdorim sot) pësoi ndryshime rrejtësore pas vitit 1990, ku regjimet e reja të marrëdhënieve të pronësisë dhe burimeve ndryshuan qasjen planifikuese.

**Reformat e para pas vitit 1990**, sektori i planifikimit i kaloi në vitin 1993 dhe 1998, ku qasja ishte vazhdimësi e mendësisë urbanistike. Planifikimi i territorit kufizohej brenda 'vijave të verdha', apo në zona të reja për zhvillim, kryesisht me karakter turistik dhe infrastrukturor. Reformat e vërteta të sektorit, të cilat do ta shkëpusnin planifikimin e territorit nga e shkuara urbanistike, erdhën në vitin 2009 dhe u konsoliduan në vitin 2014, ku planifikimi u konceptua si i integruar dhe gjithëpërfshirës dhe dokumentet e planifikimit marrin tashmë në studim dhe konsideratë të gjitha territorin.

**Para viteve '90**, në kushtet e burimeve të centralizuara dhe pronësisë publike mbi tokën, proceset dhe punët që lidheshin me ndërtimin, njiheshin me emërtimin urbanistikë. Urbanistika mbyllte ciklin e planifikimit që kishte natyrë ekonomike dhe financiare. Urbanistika ishte përkthimi në territor i vendimeve politike e ekonomike të pushtetit, të cilat i ndiqte në mënyrë lineare.

**Urbanistika** prodhonte udhërrëfyes për krijimin e vendbanimeve të reja, qytetave të punës/torëve, ndërtimin e zonave industriale, ndërtimin e lagjeve të reja të banimit, ndërtimin e fermave të reja, ndërtimin e zonave të pushimit në bregdet e në mal. Gjithashtu urbanistika prodhoi edhe disa dokumente rregullatorë me karakter zonimi, për territore më të mëdha, si studime për përcaktimin e 'vijës së verdhë', plane të përgjithshme rregulluese, apo studime rajonale (rrethi) sektoriale.

1 Analiza e Zbatimit të Funkcionit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit - DRAFT Realizuar në Kuadër të Procesit të Reformës së Decentralizimit - Qershor 2014 - përgatitur nga Dritan Shutina dhe Rudina Toto

